



Founded by
the European Union



UNOPS



MANUAL

Arkeologu i vogël



TED

A u t o r : **Dr. Elio Hobdari, Arkeolog**

Trajnim Edukim Demokraci



© *Aplikimet për leje për të shumëfishuar ose përkthyer pjesë nga ky Manual duhet të dërgohen në:*

Qendra Trajnim Edukim Demokraci

Rr. Him Kolli, Palati ISHIP, Tiranë, Shqipëri.

Email: qendrated@gmail.com

Webmail: www.ted.al

Qendra TED është një organizatë jo-fitimprurëse, pa antarësi, e themeluar në vitin 2015. TED kontribuon në fushën e të drejtave të njeriut; respektimit të ligjshmërisë dhe shtetit të së drejtës; kërkimit dhe studimit; edukimit të vlerave demokratike dhe qytetare; lobingut dhe avokatisë; dhe fuqizimit të grupeve të marginalizuara.

Fushat kryesore të veprimtarisë së saj përfshijnë:

- Kërkim-studimi dhe raportimi në çështjet ekonomike, sociale dhe mjedisore etj;
- Monitorimi, dokumentimi, informimi, raportimi dhe vlerësimi i situatës mbi të drejtat e njeriut, vlerësimin e zhvillimit ekonomik, proceset demokratike në Shqipëri, etj.
- Edukimi-trajnimi për ndërgjegjesimin e grupeve dhe shtresave të caktuara të shoqërisë shqiptare, lidhur me parimet dhe Institucionet bashkekohore të demokracisë shtetit të së drejtës, zhvillimit të qëndrueshëm si dhe çdo parimi dhe vlerë integruese drejt Bashkimit Evropian.

Ky produkt është prodhuar nga Qendra TED me financim të Bashkimit Evropian nëpërmjet skemës së granteve EU4Culture të zbatuar nga UNOPS në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës. Qendra TED është i vetmi përgjegjës për përmbajtjen e këtij produkti dhe nuk paraqet domosdoshmërisht pikëpamjet apo qëndrimin e Bashkimit Evropian dhe/ose UNOPS.

Contents

Metodologjia dhe Grupet e synuara	4
Hyrje në Arkeologji	8
1.1 Çfarë është arkeologjia?	9
1.2 Rëndësia e arkeologjisë dhe roli i arkeologëve	10
1.3 Arkeologjia e terrenit	10
1.4 Si mund të realizojmë një projekt arkeologjik? / Cilat janë hapat e një projekti arkeologjik?	12
 Zbulimi i së kaluarës: Metoda dhe teknika	 14
2.1 Gjetja e siteve arkeologjike	14
2.2 Vëzhgime ajrore	15
2.3 Hulumtimi Sipërfaqësor	18
2.4 Vëzhgimi gjeofizik	23
2.5 Zbulimet rastësore	24
 Gërmimi i sitit	 26
3.1 Stratigrafia në përgjithësi	27
3.2 Gërmimi arkeologjik	29
3.3 Siguria në kantier	33
3.4 Stafi pajisjet dhe logjistika	35
 Dokumentimi	 40
4.1 Skedat	40
4.2 Dokumentimi grafik	42
4.3 Dokumentimi fotografik	45
4.4 Regjistrimi i materialit arkeologjik	48
 Fjalort	 53

Metodologjia dhe Grupet e synuara

Trashëgimia Kulturore e transmetuar nga e kaluara në të tashmen është shumë e rëndësishme sepse komunitetet e identifikojnë veten përmes tyre dhe krijojnë një ndjenjë përkatësie dhe ndërlidhje me kulturën dhe rrënjët e tyre. Në këtë aspekt është e nevojshme që angazhimi i anëtarëve të komunitetit në mbrojtjen dhe promovimin e Trashëgimisë Kulturore të ndodhë që në moshë të vogël kur ato janë në fazën e zhvillimit të tyre kulturor dhe karakterial.

Edukimi dhe informimi mbi Trashëgiminë Kulturore i mundëson moshave të reja të marrin njohuri dhe vetëdije për vlerat kulturore dhe të rrënjosin brenda vetes rëndësinë e ruajtjes dhe konservimit të trashëgimisë kulturore edhe tek brezat e ardhshëm. Fatkeqësisht sistemi aktual arsimor në Shqipëri i ofron të rinjve njohuri të kufizuara mbi Trashëgiminë Kulturore.

Projekti “Rinia Shqiptare - E Ardhma e Trashëgimisë Kulturore” konsiston në zhvillimin dhe zbatimin e aktiviteteve të ndryshme informuese dhe edukuese që synojnë të rrisin pjesëmarrjen e të rinjve në aktivitete vullnetare për promovimin dhe mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore në qytetin e Durrësit. Në të njëjtën kohë Projekti do të përfshijë në aktivitete të ndryshme dhe mësuesit në mënyrë që të ketë një përmirësim të aftësive të tyre profesionale përsa i përket edukimit mbi Trashëgiminë Kulturore. Projekti do të implementohet gjatë periudhës Prill 2023 -Janar 2024 në qytetin e Durrësit.

Objekti i përgjithshëm i projektit konsiston në ndërgjegjësimin e rinjve mbi rolin e Trashëgimisë Kulturore si një promotor i zhvillimit të qëndrueshëm socio-ekonomik nëpërmjet:

- 1) Përfshirjes së të rinjve në proceset vendimarrëse të lidhura me Trashëgiminë Kulturore;
- 2) Ndërhyrjes së dretpërdrejtë për mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore duke identifikuar dhe kataloguar artefakte të dëmtuara dhe që kanë nevojë për restaurim.

Ky manual ka si qëllim të nxisë pjesëmarrjen e të rinjve në aktivitete konkrete për mbrojtjen dhe promovimin e Trashëgimisë Kulturore të qytetit të Durrësit. Edukimi mbi kulturën dhe historinë e qytetit do t'i informojë të rinjtë e Durrësit mbi rëndësinë dhe vlerat që paraqesin objektet e Trashëgimisë Kulturore dhe rëndësinë që këto vlera të ruhen dhe përcillen tek brezat e ardhshëm.

Komunikimi i vlerave të trashëgimisë kulturore nga e shkuara në të tashmen ka një rëndësi thelbësore në përcaktimin e identitetit dhe bashkimin e komuniteteve. Elementët kulturorë të përbashkët i japin anëtarëve të një shoqërie ndjenjën e përkatësisë dhe krenarisë për të shkuarën e tyre.

Është shumë e rëndësishme që Edukimi mbi Trashëgiminë Kulturore dhe Arkeologjinë të nisë që në moshë të re. Fëmijët dhe të rinjtë duhet të informohen mbi vlerat kulturore dhe historinë e komunitetit ku jetojnë, në mënyrë që të lartësojnë aspektet pozitive, dhe pse jo, të mësojnë nga gabimet e të shkuarës.

Përpos aspektit shpirtëror, sot Trashëgimia Kulturore luan dhe një rol të rëndësishëm si promotor i zhvillimit ekonomik, sidomos në zonat të cilat kanë potencial të lartë në fushën e turizmit. Durrësi është një nga qytetet me numrin më të lartë të turistëve në Shqipëri. Pjesa më e madhe e turistëve e vizitojnë këtë qytet gjatë sezonit veror për të shijuar bregdetin e këtij qyteti. Edhe pse ka patur një rritje në numrin e turistëve që vizitojnë sitet kulturore, përsëri jemi larg shfrytëzimit të potencialit real që Durrësi ofron.

Aspekti kulturor i këtij qyteti nuk është i njohur mjaftueshëm për turistët, dhe gjithashtu neglizhohet dhe nga banorët vendas. Për reklamimin e Trashëgimisë Kulturore dhe Arkeologjisë tek turistët e huaj është e nevojshme të zhvillohen fushata publicitare, ndërsa për ndërgjegjësimin e komunitetit mbi vlerat e kulturës dhe historisë së Durrësit nevojitet më shumë punë.

Veprimtaria ndaj trashëgimisë kulturore, në veçanti ndaj pasurisë arkeologjike është e vazhdueshme dhe shumë dinamike. Krahas mbrojtjes, vlerësimit dhe promovimit të vlerave të njohura, të tjera objekte pjesë e trashëgimisë kulturore dalin në dritë. Ato kërkojnë edhe qasje të reja në përputhje me kriteret dhe nevojat e kohës. Në këtë kuadër përfshirja e komuniteteve, në veçanti e të rinjve, në moshë shkollore dhe në momentin e hyrjes së tyre në tregun e punës, bëhet një element i rëndësishëm për mbrojtjen, zhvillimin dhe përdorimin e drejtë të kësaj trashëgimie në funksion të zhvillimit.

Është e rëndësishme që trashëgimia arkeologjike si pjesë përbërëse e trashëgimisë kulturore të vendit të perceptohet në mënyrën e duhur dhe në tërësinë e saj. Për këtë, publiku dhe në veçanti të rinjtë duhet të jenë të informuar jo vetëm për ekzistencën dhe vlerat e saj, por edhe për mënyrën se si ajo del në dritë dhe vlerësohet. Një pjesë e madhe e suksesit në menaxhimin e kësaj trashëgimie varet edhe nga sjellja dhe kontributi i publikut, përveç detyrimeve të institucioneve shtetërore kompetente. Prandaj njohja e qytetarëve me tërësinë e proceseve të punës që çojnë në shtimin dhe përmirësimin e trashëgimisë arkeologjike është i rëndësishëm dhe duhet të marrë një vend edhe në edukimin shkollor.

Trashëgimia arkeologjike nuk janë vetëm monumentet e rëndësishme, ndër të cilat spikasin një numër i konsiderueshëm në qytetin e Durrësit, por edhe gërmimet arkeologjike në dukje të thjeshta dhe të parëndësishme. Madje në të tilla raste metodologjia e punës bëhet edhe më e rëndësishme me qëllim marrjen e informacionit sa më të plotë. Vetëm në këtë mënyrë edhe monumentet e konsideruar “të rëndësishëm” marrin një kuptim më të plotë dhe ndërtohet një panoramë më e saktë e të kaluarës së vendbanimeve të vendit tonë.

Ky tekst synon t’i shërbejë pikërisht këtij edukimi të nevojshëm për brezin e ri që monumentet e së kaluarës të mos i shohë të shkëputura nga peizazhi urban i sotshëm, por si indikator i asaj se çfarë këto qytete kanë përgjatë historisë dhe si kanë evoluar për të ardhur deri në ditët e sotshme.

Numri i të rinjve në Shqipëri është relativisht i lartë, rreth 25% e popullsisë është në moshë të re (15-29 Vjeç). Edukimi luan një rol të rëndësishëm në rritjen e ndërgjegjësimit të të rinjve për mbrojtjen dhe transmetimin e trashëgimisë kulturore dhe informimit mbi teknikat e arkeologjisë. Për më tepër, edukimi mbi trashëgiminë kulturore rrit aftësinë e të rinjve për t’u bërë jo vetëm qytetarë model, për të jetuar në shoqëri me një ndjenjë më të madhe përbushjeje, por edhe qytetarë të përgjegjshëm në lidhje me detyrimin moral ndaj mbrojtjes së trashëgimisë kulturore.

Aktivitete konkrete të projektit “Rinia Shqiptare - E Ardhma e Trashëgimisë Kulturore” do të zhvillohen në shkollat dhe qendrat komunitare të qytetit të Durrësit, por Manuali mund të ketë një përdorim më të gjerë, edhe pse u drejtohet grupmoshave më të reja, Manuali ofron informacione dhe kuriozitete të dobishme për këdo që dëshiron të mësojë më shumë mbi arkeologjinë dhe trashëgiminë kulturore.



Hyrje **në** Arkeologji

1.1 Çfarë është arkeologjia?

Arkeologjia është një disiplinë shkencore e cila merret me studimin e veprimtarisë njerëzore nëpërmjet rikuperimit dhe analizës së kulturës materiale¹. Të dhënat arkeologjike përbëhen nga artefakte, arkitekturë, biofakte ose ekofakte, site dhe peizazhe kulturore. Këto përfshijnë artefakte që nga veglat më të hershme prej guri deri te objektet e bëra nga njeriu që janë varrosur ose hedhur në ditët e sotme: nga veglat e thjeshta te makineritë komplekse, nga shtëpitë dhe tempujt dhe varret më të hershme te pallatet, katedralet dhe piramidat². Hulumtimet dhe gërmimet arkeologjike janë burimi kryesor i njohurive të kulturave parahistorike, antike dhe të zhdukura. Etimologjikisht rrjedhur nga termat grekë “arhaia” (gjëra të lashta) dhe “logos” (teori ose shkencë)³, kjo disiplinë shkencore njihet gjerësisht si një shkencë sociale dhe një degë e dalluar e shkencave humane, me lidhje të ngushta me fushën e antropologjisë⁴.

Disiplina përfshin hulumtimin, gërmimin dhe analizën e të dhënave të mbledhura, për të mësuar më shumë për të kaluarën. Në një shtrirje të gjerë, arkeologjia mbështetet në kërkime ndërdisiplinore. Ajo u zhvillua nga antikuarizmi në Evropë gjatë shekullit të 19-të dhe që atëherë është bërë një disiplinë e praktikuar në mbarë botën⁵. Që nga zhvillimi i saj i hershëm, arkeologjia ka evoluar në një fushë të larmishme me nëndisiplina të ndryshme specifike, secila duke u fokusuar në aspekte të dallueshme të së kaluarës njerëzore. Këto nëndisiplina përfshijnë arkeologjinë detare, bioarkeologjinë, numizmatikën, epigrafinë, etj. Krahës tyre dhe shumë teknika të ndryshme shkencore janë zhvilluar për të ndihmuar hetimin arkeologjik.

1 David L. Clarke, *Analytical archaeology*, “Methuen & Co. Ltd.”, 1968, f. 12, 21

2 Peter L. Drewett, *Field Archaeology: An Introduction*, “University College London”, 1999, f. 2-3;

3 N. Ceka, M. Korkuti, *Arkeologjia*, “Libri Universitar”, 1998, f. 5

4 Colin Renfrew, Paul Bahn, *Archaeology: Theories, Methods, and Practice*, “Thames & Hudson”, 2012, f. 12

5 Donald Henson, *Doing Archaeology: A Subject Guide for Students*, “Routledge”, 2012, f. 12

1.2 Rëndësia e arkeologjisë dhe roli i arkeologëve

Arkeologjia ka një rëndësi të thellë në shoqërinë bashkëkohore, duke kontribuar jashtëzakonisht shumë në të kuptuarit tonë të së kaluarës dhe në formësimin e trashëgimisë sonë kolektive⁶. Si disiplinë, ajo është e përkushtuar të zbulojë, analizojë dhe interpretojë mbetjet materiale nga qytetërimet e lashta dhe periudhat historike⁷. Duke ekzaminuar artifaktet, strukturat dhe depozitat kulturore, arkeologët rindërtojnë sjelljen e kaluar njerëzore, organizimin shoqëror, përparimet teknologjike dhe praktikat kulturore⁸. Nëpërmjet kërkimit të tyre, arkeologët ofrojnë njohuri thelbësore për evolucionin e shoqërive njerëzore dhe ndërveprimet e tyre me mjedisin, duke hedhur dritë mbi çështje thelbësore si diversiteti kulturor, ndryshimet klimatike dhe zhvillimi i qytetërimeve komplekse. Për më tepër, arkeologjia luan një rol vendimtar në menaxhimin dhe ruajtjen e trashëgimisë⁹, duke ruajtur burime të paçmueshme kulturore për brezat e ardhshëm.

1.3 Arkeologjia e terrenit

Arkeologjia e terrenit përfshin faza të ndryshme, duke përfshirë jo vetëm punën fizike të kryer në terren, por edhe përgatitjet e gjera para terrenit dhe analizat thelbësore pas terrenit. Kur përmendet termi "arkeologjia e terrenit", ai shpesh përfshin më shumë sesa thjesht teknika gërmimi, pasi përfshin një sërë metodash jo-destruktive në terren të përdorura për të identifikuar dhe vlerësuar zonat me interes arkeologjik (sitet). Ndërsa gërmimi është ndër teknikat e përdorura nga arkeologët në terren, ai shquhet si metoda më gjithëpërfshirëse dhe potencialisht informuese në dispozicion të tyre, pavarësisht natyrës së saj shkatërruese. Megjithatë, rëndësia e tij qëndron në pasurinë e informacionit të detajuar që mund të japë.

6 Referuar Ligjit Nr. 27/2018, "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë", Neni 50: Tipologjitë e pasurive kulturore materiale, pika 3/ç

7 David L. Clarke, *Analytical archaeology*, "Methuen & Co. Ltd.", 1968, f. 12, 2

8 N. Ceka, M. Korkuti, *Arkeologjia*, "Libri Universitar", 1998, f. 9-11

9 Referuar Ligjit Nr. 27/2018, "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë", Neni 7: Ruajtja dhe mbrojtja e pasurive kulturore, pika 2

Arkeologjia në terren fillon me vendndodhjen e siteve arkeologjike. Siti arkeologjik është një sipërfaqe në të cilën është kryer aktivitet njerëzor dhe në të cilën ruhen artefakte dhe/ose struktura të ndërtuara nga njeriu. Fillimisht, pyetja kryesore për t'u adresuar është "PSE?". Në rastin më të thjeshtë përgjigja do të ishte *"për të parë nëse ka aktivitet/arkeologji të pranishme"*, por ky justifikim nuk është më i mjaftueshëm në kohët bashkëkohore. Motivimet pas ndërmarrjes së një gërmimi arkeologjik, i cili në thelb është destruktiv, janë bërë gjithnjë e më sfiduese për t'u vendosur. Prandaj, përpara se të filloni ndonjë gërmim, përgatitja e projektit është parësore¹⁰.

Projekti duhet të përfshijë një përshkrim të detajuar të zonës së kërkimit (sitet), të përcaktuar me saktësi në një hartë të gjeoreferencuar. Gjithashtu jepen detaje pronësie dhe informacione për sipërfaqen ku do të bëhet gërmimi. Nëse siti gëzon ndonjë formë mbrojtjeje nga shteti, si p.sh. të qenit pjesë e një parku natyror kombëtar (Butrint), ai duhet të specifikohet qartë. Përcaktohen gjithashtu punët e tjera arkeologjike të kryer në sit, pasi të gjitha ndërhyrjet e mëparshme kanë pasur një ndikim destruktiv. Edhe hulumtimet sipërfaqësore dhe mbledhja e qeramikës ndryshojnë sitin dhe kërkohet të dokumentohet dhe të njihet. Cilësia e punës së kaluar arkeologjike në sit vlerësohet për të përcaktuar besueshmërinë e informacionit të mbledhur, duke marrë parasysh përdorimin e teknikave të vjetruara ose faktorëve të tjerë.

Një aspekt thelbësor i përgatitjes së projektit është përpjekja për të vendosur kronologjinë e përdorimit të sitit (vendbanimit), duke përshkruar pritshmëritë bazuar në periudhat historike. Megjithatë, pavarësisht planifikimit të përpiktë të projektit, puna në terren shpesh sjell çështje të papritura dhe pyetje të reja. Arkeologu duhet të jetë i gatshëm dhe fleksibël, pasi informacionet e reja që dalin gjatë gërmimit nuk mund të anashkalohen. Në raste të tilla, arkeologu duhet t'i inkorporojë këta faktorë të paparashikuar në kërkimin e tyre pa hezitim, pasi nuk ka mundësi për të rishikuar sitin e gërmimit më vonë.

¹⁰ Bazuar VKM Nr. 220, datë 7.4.2021, "Për kushtet e posaçme të lëshimit të lejes, dokumentatve shoqërues, si dhe procedurat për shqyrtimin ose revokimin e lejes për kryerjen e hulumtimeve arkeologjike"

Ekzistojnë tre grupe kryesore të përfshira në arkeologjinë në terren:

1) **Arkeologët që bëjnë kërkime shkencore:** Ky grup fokusohet në kryerjen e hetimeve rigoroze shkencore në site arkeologjike. Ata synojnë të zbulojnë njohuritë historike dhe të kuptojnë më mirë të kaluarën përmes gërmimeve, hulumtimeve dhe analizave të tyre.



2) **Arkeologët që punojnë në terren në kuadër të menaxhimit të trashëgimisë:** Janë përgjegjës për menaxhimin dhe ruajtjen e siteve dhe monumenteve të trashëgimisë kulturore. Puna e tyre përfshin restaurimin, ndërhyrjet konservuese dhe krijimin e infrastrukturës për vizitën dhe promovimin e tyre.



3) **Vullnetarët:** Ka individë që punojnë vullnetarisht në arkeologjinë e terrenit. Megjithatë jo gjithmonë arkeologë profesionistë, kontributi i tyre mund të jetë i vlefshëm në projekte të ndryshme arkeologjike.



Megjithatë, ekziston një shqetësim i madh në lidhje me gërmuesit klandestinë, të cilët gjithashtu ndërhyjnë në zonat arkeologjike. Këta individë janë kryesisht të interesuar në gjetjen e objekteve me vlerë për përfitime monetare dhe mund të përdorin metoda arkeologjike pa iu përmbajtur etikës profesionale dhe procedurave të duhura kërkimore.

1.4 *Si mund të realizojmë një projekt arkeologjik? / Cilat janë hapat e një projekti arkeologjik?*

Përfshirja e një seksioni “menaxhimi” në një libër shkollor hyrës mbi arkeologjinë e terrenit mund të duket fillimisht jokonvencionale. Historikisht, tekstet klasike të arkeologjisë së terrenit nuk e kanë trajtuar në mënyrë eksplicite “menaxhimin” si lëndë. Megjithatë, është e rëndësishme të pranohet

se kushdo në një pozicion autoriteti brenda një projekti arkeologjik, si një mbikëqyrës sondazhi ose drejtues projekti, merr në thelb një rol menaxherial. Kështu, njohja dhe kuptimi i parimeve të "menaxhimit" bëhet thelbësor për përpjekjet e suksesshme arkeologjike.

Menaxhimi, si arkeologjia, përfshin interpretime të ndryshme në varësi të praktikuesve të përfshirë. Kryesisht, ato i referohen procesit sistematik të planifikimit, organizimit, drejtimit, koordinimit, kontrollit dhe mbikëqyrjes së aktiviteteve me fokus në arritjen e rezultateve të dëshiruara. Ndërsa konceptet e menaxhimit zakonisht lidhen me operacionet e biznesit, të tilla si prodhimi ose ndërtimi, rëndësia e tyre shtrihet në mënyrë të barabartë me projektet e fushës arkeologjike. Çdo projekt arkeologjik kërkon planifikim të kujdesshëm, ekzekutim efikas dhe arritjen e rezultateve të dëshiruara.

Menaxhimi efektiv i projekteve në terren përfshin dy komponentë kryesorë¹¹.

- 1) E para ka të bëjë me aspektin procedural, duke përfshirë renditjen sistematike të aktiviteteve, përdorimin e teknikave dhe pajisjeve të përshtatshme.
- 2) Aspekti i dytë ka të bëjë me personelin/ekipin e përfshirë në projekt. Ndryshe nga pajisjet e punës, si p.sh. një mistri, individët nuk mund të futen thjesht brenda dhe jashtë projektit si burime të përkohshme. Në vend të kësaj, nxitja e ndjenjës së përfshirjes dhe përgjegjësisë midis anëtarëve të ekipit është thelbësore, pasi rrit ndjeshëm rezultatet e projektit. Neglizhimi i këtij aspekti njerëzor mund të jetë i dëmshëm për suksesin e projektit. Për më tepër, një aspekt i rëndësishëm i menaxhimit efektiv të një projekti arkeologjik është administrimi i saktë i kohës dhe burimeve financiare. Vendosja e një afati kohor të mirëpërcaktuar për projektin e përgjithshëm dhe elementet e tij individuale, së bashku me një sekuençë të qartë detyrash, rezultojnë të jetë i domosdoshëm në këtë drejtim.

11 Peter L. Drewett, *Field Archaeology: An Introduction*, "University College London", 1999, f. 14-15.

Zbulimi i së kaluarës: Metoda dhe teknika

2.1 Gjetja e siteve arkeologjike

"Si e dinë arkeologët se ku të gërmojnë?" Arkeologët përdorin metodologji të ndryshme për të përcaktuar vendndodhjet e siteve arkeologjike. Identifikimi dhe regjistrimi i zonave të tilla në peizazh mbështetet në teknikat e vëzhgimit ose zbulimit, të klasifikuara gjerësisht në tre kategori kryesore: vëzhgime ajrore (*sensor në distancë*), hulumtime sipërfaqësore dhe sondazhe (testing pits). Secila prej këtyre qasjeve luan një rol vendimtar në identifikimin dhe regjistrimin e siteve arkeologjike në peizazh.

Anasjelltas, vlen të përmendet se shumë site arkeologjike nuk kanë humbur kurërë. Vendndodhja mund të jetë braktisur, por mund të mbetet qartësisht e dukshme në peizazh edhe nëse, gjatë pjesës më të madhe të jetës së tij pas përdorimit, nuk është konsideruar si një sit arkeologjik. Sitete të tilla të njohura si Stonehenge, Muri i Madh i Kinës dhe Akropoli në Athinë, etj kanë qenë gjithmonë të njohura. Kjo është përgjithësisht e zbatueshme për site të rëndë-



Siti arkeologjik i Amantias i parë nga ajri

sishme, shpesh duke përfshirë sitet kryesore brenda një rajoni të caktuar. Megjithatë, është thelbësore të pranohet se jo të gjitha sitet arkeologjike kanë pasur fatin të ruajnë njohjen e vazhdueshme.

Dukshmëria e një siti arkeologjik nuk lidhet gjithmonë me madhësinë e tij; në disa raste, sitet më të vogla mund të jenë më të prirura për t'u "humbur" me



Një sit i përdorur përkohësisht (në këtë rast një stan) është më i prirur për të humbur me kalimin e kohës

kalimin e kohës sesa ato më të mëdha. Megjithatë, edhe site të konsiderueshme mund të mbeten "të humbura" për arkeologët, pavarësisht se janë të njohura për popullatën vendase. Ngjarje të tilla nënvizojnë kompleksitetin dhe sfidat e natyrshme në kërkimin dhe ruajtjen arkeologjike, duke theksuar rëndësinë e përdorimit të metodave të përpikta të hulumtimit për të zbuluar dhe mbrojtur këto mbetje të vlefshme të së kaluarës sonë¹².

2.2 Vëzhgime ajrore

Fotografia ajrore është mjeti më i hershëm, dhe akoma i rëndësishëm, i ndijimit nga distanca në dispozicion të arkeologëve që kërkojnë site të reja arkeologjike. Zbulimi në distancë përfshin çdo teknikë që kap të dhëna gjeografike nga sensorë në një distancë nga sipërfaqja që regjistrohet. Elementet kryesore të sensorit në distancë janë fotografia ajrore, imazhet satel-

¹² Peter L. Drewett, *Field Archaeology: An Introduction*, "University College London", 1999, f. 31

itore dhe gjeofizika¹³. Të gjitha të dhënat e mbledhura përmes sensorit në distancë mund të ndahen, kombinohen dhe manipulohen përmes aktivitetit të përpunimit të imazhit, i cili formon një nga elementët kryesorë të *Sistemeve të informacionit gjeografik (GIS)* ¹⁴.

Disa veçori arkeologjike janë më të spikatura nga ajri sesa kur vëzhgohen në tokë. Kjo është kryesisht për shkak të natyrës së këtyre veçorive dhe ndikimit të proceseve të formimit pas braktisjes së sitit. Metodat e sensorit në distancë mund të zbulojnë në mënyrë efektive këto vende, pasi ato shpesh shfaqin ndryshime të dallueshme në tokë ose nëntokë, të tilla si kanale, gropa, brigje, tuma, mure, etj, të cilat shpesh janë të dukshme në reliev¹⁵.



Ndryshimet e vogla në kushtet e tokës të shkaktuara nga tiparet e varrosura mund të theksohen dhe shihen nga ajri përmes disa faktorëve:

- 1) Shenjat e hijeve (*Shadow marks*): Kur dielli është i ulët, edhe ndryshimet e vogla në nivelet e tokës mund të krijojnë hije, duke i bërë ato më të dukshme nga perspektiva ajrore ¹⁶

¹³ Peter L. Drewett, *Field Archaeology: An Introduction*, "University College London", 1999, f. 37

¹⁴ Valbona Hysa, Nevila Molla, *Manual mbi Praktikat Arkeologjike në Terren*, "Albania Heritage Foundation", 2009, f. 17-2

¹⁵ Peter L. Drewett, *Field Archaeology: An Introduction*, "University College London", 1999, f. 37-38

¹⁶ Peter L. Drewett, *Field Archaeology: An Introduction*, "University College London", 1999, f. 39

- 2) Shenjat e vegjetacionit (*Cropmarks*): Kanalet dhe muret e groposura mund të ndryshojnë mbajtjen e ujit në tokë. Si rezultat, të korrat që rriten mbi tipare të tilla të varrosura mund të duken më të gjata ose më të shkurt-ra se toka e patrazuar përreth, duke krijuar dallime tonale ose ngjyra që ndihmojnë në përcaktimin e këtyre strukturave të fshehura. Për më tepër, gjatë dimrit, "shenjat e ngricës" mund të formohen në fushat e lëruara, duke theksuar akumulimin e ujit përgjatë vijave të tipareve të groposura ¹⁷.
- 3) Shenjat e tokës (*Soil marks*): Fushat e lëruara mund të shfaqin dallime të vogla në ngjyrën e tokës midis depozitimeve natyrore dhe atyre arkeolog-ike (artificiale), duke i bërë këto ndryshime të dukshme nga lart¹⁸.



- 4) Hidro-shenja (*Damp marks*): Prania e veçorive të groposura dhe dallimet në nivelet e tokës mund të ndikojë në mënyrën se si sillet uji sipërfaqësor në një zonë, duke çuar në efekte të dukshme pas reshjeve të mëdha¹⁹.

¹⁷ Peter L. Drewett, *Field Archaeology: An Introduction*, "University College London", 1999, f. 39-41

¹⁸ Peter L. Drewett, *Field Archaeology: An Introduction*, "University College London", 1999, f. 41

¹⁹ Fulong Chen, et al., *Investigating Luoyang by Remote Sensing: First Results*. In: Masini, N., Soldovieri, F. (eds) *Sensing the Past, Geotechnologies and the Environment*, vol 16, "Springer", 2017, f. 541

Si përfundim, martesa e arkeologjisë me teknologjitë më të avancuara si dronët, GIS, LiDAR dhe fotogrametria shënon një revolucion novator në fotografimin dhe dokumentacionin në distancë. Këto mjete të fuqishme kanë tejkaluar kufizimet e metodave tradicionale, duke u mundësuar arkeologëve dhe studiuesve të eksplorojnë dhe studiojnë sitet arkeologjike me saktësi, shpejtësi dhe efikasitet.



2.3 *Hulumtimi Sipërfaqësor*

Sitet arkeologjike shpesh/gjithashtu identifikohen përmes hulumtimeve sipërfaqësore, të cilat përbëjnë një qasje themelore në kërkimin arkeologjik. Metodat e përdorura për këto hulumtime ndryshojnë në bazë të objektivave specifike, kufizimeve kohore dhe burimeve financiare të disponueshme për studimin. Ajo mund të kategorizohet nga dy lloje: (a) ekstensive ose (b) intensive, të cilat përcaktohen nga pyetjet specifike kërkimore të drejtuara drejt peizazhit nën hetim. Këto metodologji studimi shërbejnë jo vetëm si një mjet praktik për të vlerësuar qëndrueshmërinë e kryerjes së një gërmimi duke dokumentuar detaje themelore të një siti të mundshëm, por edhe si qëllime të vlefshme në vetvete. Nëpërmjet hulumtimeve, mund të nxirren njohuri të rëndësishme në aktivitetet e kaluara njerëzore brenda një konteksti rajonal, duke kontribuar kështu në një kuptim më të thellë të peizazheve historike dhe rëndësisë së tyre kulturore.

Hulumtimet sipërfaqësore luajnë një rol vendimtar në vlerësimin e rëndësisë së mundshme arkeologjike të zonave të caktuara për zhvillim, shpesh të lidhura me projekte ndërtimi. Objektivi kryesor i këtyre hulumtimeve është


të përcaktojë nëse zona e zhvillimit ka të ngjarë të përmbajë potencial të rëndësishme arkeologjike. Bazuar në gjetjet e tyre, arkeologët më pas bëjnë rekomandime në lidhje me nevojën për të shmangur mbetjet arkeologjike ose nëse gërmimi është i nevojshëm përpara fillimit të punës zhvillimore.

Siç u përmend më lart, hulumtimet sipërfaqësore mund të klasifikohen në dy lloje: ekstensive dhe intensive.

- 1) Hulumtimi Ekstensiv: karakterizohet nga një qasje me rezolucion të ulët mbi objektivat brenda një zone të studimit (duke përfshirë disa qindra m²). Ndonjëherë kjo përfshin një kampionim të rastësishëm ose një lloj tjetër kampioni probabiliteti për të fituar një kampion përfaqësues të zonës së studimit. Hulumtimet ekstensive zakonisht përdoren për identifikimin e siteve arkeologjike në një zonë të madhe dhe shpesh favorizohen për kosto-efektivitetin e tyre.



Arkeologë gjatë vëzhgimit arkeologjik të terrenit




Linjat e ecjes me hapesira të barabarta

- 2) Hulumtimi Intensiv: karakterizohet nga mbulimi i plotë ose pothuajse i plotë i zonës së studimit me një rezolucion të lartë, shpesh duke pasur grup arkeologësh anketues që ecin në mënyrë sistematike mbi parcelat në fjalë, duke dokumentuar artefakte si litik, qeramika dhe/ose mbetje

arkitektonike. Megjithatë, efektiviteti i arritjes së mbulimit të plotë ndikohet nga faktorë të ndryshëm si topografia, vegjetacioni dhe karakteristikat e tokës, të cilat mund të ndikojnë në evidentimin e artefakteve. Përbehet nga dy qasjeve kryesore:

- a) Hulumtim këmbësorë (*Pedestrian Survey*, e njohur ndryshe dhe si *Mediterranean Survey*)²⁰ : si rregull, në çdo trakt duhet dhënë orientimi në gradë nëpërmjet busullës. Vrojtuesit, me një distance jo më shumë se 5-10 metra larg njëri-tjetrit, ndjekin orientimi të përcaktuar. Megjithatë, në rastin e relievve kodrinore ose të thyera, duke qenë se drejtimi i ecjes dhe hapësira mund të ndryshojë për shkak të terrenit, ecja vazhdon duke ndjekur formën e terrenit²¹ .
- b) Hulumtimi i sipërfaqes me kuadrate (*Gridded Surface Survey*): Për hulumtime më intensive, sistemi i kuadrateve është më i përshtatshëm. Madhësia e tyre varet nga sasia e informacionit që synohet të përfitohet. Zakonisht, kuadratet janë 20 × 20 m ose 30 × 30 m, megjithëse ato mund të vendosen për të qenë më të mëdhenj ose më të vegjël sipas nevojës²² .



²⁰ P. Attema, et al., *A guide to good practice in Mediterranean surface survey projects*, "Journal of Greek Archaeology", vol 5:1, 2020, f. 2

²¹ Valbona Hysa, Nevila Molla, *Manual mbi Praktikat Arkeologjike në Terren*, "Albania Heritage Foundation", 2009, f. 25

²² Peter L. Drewett, *Field Archaeology: An Introduction*, "University College London", 1999, f. 47

Në fillim të çdo hulumtimi, vrojtuesit vendosen në njërën anë të traktit/kuadratis, të shënuar si pikënisja e tij. Në drejtimin e drejtuesit të grupit, ata kalojnë në anën e kundërt (fundin)²³. Më pas, objektet e mbledhura futen në qese plastike (pasi qeset prej letre nuk përdoren shumë në shi). Çdo qese është shënuar qartë me numrat e grupit dhe traktit ose kuadratis. Disa hulumtime nuk mbledhin objekte, por thjesht identifikojnë dhe numërojnë secilin lloj dhe i lënë ato *in situ*.

Është e rëndësishme që dokumentimi i të dhënave në terren të organizohet në tre kategori kryesore:

- 1) Dokumentacioni i shkruar, përshkruar dhe lokalizues: Kjo kategori fokusohet në shënimet e detajuara dhe vëzhgimet e bëra nga vrojtuesit gjatë hulumtimit në terren. Ai synon të sigurojë informacion sa më të saktë për çdo trakt ose kuadrat duke minimizuar humbjen e kohës gjatë mbledhjes së të dhënave. Dokumentacioni duhet të ndjekë një format të strukturuar dhe të përfshijë elementët e mëposhtëm:
 - a) Nr. i traktit/kuadratis, b. Grupi, c. Viti, d. Kalimet, e. Shikueshmëria, f. Vegjetacioni, g. Përshkrimi i kufijve të traktit/kuadratis, h. Nr. i qeramikës/tullave-tjegullave të traktit/kuadratis, i. Vëzhgime të mundshme.
- 2) Plani i traktit/kuadratis nëpërmjet imazheve satelitore: Kjo kategori përfshin përdorimin e imazheve satelitore për të mbështetur dhe plotësuar të dhënat në terren. Ai i ndihmon arkeologët të identifikojnë vendndodhjet e sakta të trakteve ose kuadrateve të hulumtuara dhe ofron një kontekst më të gjerë për zonën e studimit.

23 Valbona Hysa, Nevila Molla, *Manual mbi Praktikat Arkeologjike në Terren*, "Albania Heritage Foundation", 2009, f. 23




- 3) **Fotografi:** Shërbejnë si një regjistrim vizual i vlefshëm i hulumtimit në terren dhe i objekteve ose veçorive të hasura. Ai shton një informacioni shtesë për qëllime dokumentimi dhe rrit të kuptuarit e zonës së studimit (p.sh. vegjetacioni ose shikueshmëria në terren).

Për t'i përmbushur këto detyra në mënyrë efektive, arkeologët përdorin një sërë mjeteve në përpjekjet e tyre hulumtuese. *Sistemet e Informacionit Gjeografik (GIS), Sistemet e Pozicionimit Global (GPS), teknologjitë e sensorit në distancë, hulumtime gjeofizike dhe fotografia ajrore* luajnë të gjitha role jetike për të ndihmuar hetimet dhe analizat e tyre. Integrimi i këtyre mjeteve të avancuara rrit saktësinë dhe efikasitetin e vlerësimeve arkeologjike, duke çuar në vendime të informuara më mirë në lidhje me ruajtjen dhe studimin e trashëgimisë sonë kulturore.

2.4 Vëzhgimi gjeofizik²⁴

Vëzhgimi gjeofizik është shfaqur si një mjet shumë i vlefshëm dhe me kosto efektive në arkeologjinë moderne, falë përparimeve të rëndësishme në vitet e fundit. Kjo qasje jo-invasive dhe jo-destruktive i lejon arkeologët të hartojnë në mënyrë efektive sipërfaqen e siteve arkeologjike. Instrumentet gjeofizike janë të aftë në zbulimin e veçorive të varrosura me veti elektrike ose magnetike të kundërta në krahasim me mjedisin e tyre. Edhe artefaktet individuale, veçanërisht ato prej metali, mund të identifikohen përmes këtyre metodave.



Rezultat i të kërkimit gjeofizik. Gjetja e strukturave nëntokë.

M. Berisha, Ch. Goddard, *la découverte d'une nouvelle basilique monumentale à Ivstiniiana Secvnda-Vlpiana en Dardanie (Kosovo)*, Topografia Christiana Universi Mvndi. Studi in onore di Philippe Pergola.

24 Peter L. Drewett, *Field Archaeology: An Introduction*, "University College London", 1999, f. 50-55

